



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		13. 12	2023
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	400/01-60011		



DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING	
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO	
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarsivo Lokalne Samouprave i Administrimit Ministry of Local Government Administration	
Nr. Br. No.	454-986
-11- Data Datum Date.	18.12.2023

Komuna e Glogocit
Opština Glogovac
Municipality of Glogoc

MARRËVESHJE TREPALËSHE E NËNGRANTIT 08/GLL/2023

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Rr. Luan Haradinaj, ndërtesa e re e Qeverisë (ish ndërtesa e "Rilindjes"),

Katet: 11, 12 dhe 13, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

(Agjencia zbatuese e projektit M4Y, në tekstin e mëtejme "MAPL")

Komuna e Glogocit

Rr. "Fehmi Lladrovci" pn, 13000 Glogoc

(përfituesi i projektit M4Y dhe bashkë financuesi i nëngranteve, në tekstin e mëtejme "Komuna")

dhe

Vlera Dibrani

Grup jo-formal

Nr. personal: 1249379626

Detajet e llogarisë bankare: BKT 1952003355021142

Glogoc

(në tekstin e mëtejme "Përfituesi i nëngrantit")

janë pajtuar si në vijim:

Neni 1 - Qëllimi

- 1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshje është dhënia e nëngrantit të siguar nga Qeveria e Japonisë përmes Fondit Japonez për Zhvillim Social (JSDF) i cili administrohet nga Banka Botërore dhe zbatohet nga MAPL për financimin e zbatimit të nënprojektit me titull: **"Turnir në FIFA24"** (në tekstin e mëtejshëm 'Nënprojekti').
- 1.2 Përfituesit të nëngrantit do t'i jepet granti sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, Doracakun e Operacionit të Projektit (DOP) dhe Doracakun e Nëngrantit (DNG), të cilin Përfituesi i nëngrantacionit deklaron se i ka vënë në dukje dhe pranuar.
- 1.3 Përfituesi i nëngrantit pranon grantin dhe merr përsipër të jetë përgjegjës për realizimin e Nënprojektit.

Neni 2 — Periudha e zbatimit të Nënprojektit

- 2.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të gjitha palët në marrëveshje.
- 2.2 Zbatimi i Nënprojektit fillon me datën e nënshkrimit të kontratës.
- 2.3 Projekti duhet të përfundoj implementimin deri me datën **15.06.2024**

Neni 3 — Financimi i Nënprojektit

- 3.1 Shpenzimet e përgjithshme të pranueshme përlogariten në Euro **€ 3,950.00** për Nënprojektin.
- 3.2 MAPL merr përsipër t'i ndajë 85 % të vlerës së përgjithshme të Nënprojektit nga fondi i donatorëve: **€ 3,357.50**
- 3.3 Komuna merr përsipër të financoj 15% nga buxheti i saj (15% e vlerës së përgjithshme të Nënprojektit): **€ 592.50**

Neni 4 — Rregullimet e pagesës

4.1 Për nëngrantet ku shuma e përgjithshme (kur mbledhen shuma e MAPL-së dhe komunës) ndryshon nga 1,000 deri 14,500 Euro, shuma e përgjithshme e dhënë do të paguhet si para-financim, pas nënshkrimit të marrëveshjes së Nëngrantit.

4.2 Pagesat e Nëngrantit do të realizohen në dy këste:

- 4.2.1 Kësti i parë (në shumën 15% të kontributit në nëngrant) do të paguhet nga Komuna për pjesën e saj të kontributit.
- 4.2.2 Kësti i dytë (në shumën 85% të kontributit në grantit) do të paguhet nga MAPL pas konfirmimit nga komunat pjesëmarrëse që vërteton se 15% e shumës së projektit u është shpërndarë përfituesve. Përfituesi dorëzon Kërkesën për Pagesë (Shtojca 5.1).

4.3 Për të marrë këstin, përfituesi i Nëngrantit duhet t'i siguroj MAPL-së dokumentet mbështetëse të cekura në DNG si dhe çfarëdo dokumenti tjetër shtesë që konsiderohet i nevojshëm për t'i mundësuar MAPL-së transferimin e mjeteve.

4.4 Përfshirja nga TVSH-ja, shpenzimet e kryera sipas kontratave të granteve të dhëna për operacionet e përzgjedhura do të përfshihen nga të gjitha tatimet, detyrimet doganore dhe tarifatat e tjera fiskale në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Neni 5 – Detyrimet e MAPL-së

5.1 MAPL-ja është përgjegjëse për menaxhimin e përgjithshëm financiar të projektit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). MAPL-ja do të ndajë 85% të vlerës së përgjithshme të projektit pas marrjes së konfirmimit nga komuna pjesëmarrëse që vërteton se 15% e shumës së projektit është shpërndarë për përfituesit e Nëngrantit. MAPL-ja do t'i ndajë mjetet brenda 1 muaji pas marrjes së konfirmimit nga komuna se mjetet i janë shpërndarë përfituesit të Nëngrantit.

5.1.1 MAPL-ja rezervon të drejtën për monitorimin dhe vlerësimin e realizimit të projektit, duke përfshirë financat dhe rishikimin e shpenzimeve në vazhdimësi në çdo kohë gjatë projektit përmes njoftimit paraprak prej shtatë ditësh. MAPL-ja do të pranojë vetëm pagesa të cilat janë në përputhje me shumën e dhënë të Nëngrantit siç parashihet në aplikacionin për Nëngrant.

5.1.2 MAPL është e obliguar që të bëjë aprovimin e planit të prokurimit të përfituesve. Pa e bërë aprovimin e planit të prokurimit për përfituesit, përfituesit nuk mund të zhvillojnë procedura për aktivitetet e prokurimit.

Neni 6 – Detyrimet e komunës

6.1 Komuna është përgjegjëse për menaxhimin e fondeve (15% të vlerës së përgjithshme të nënprojektit) të ndara për përfituesit e nëngrantit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Komuna do t'i ndajë 15% të vlerës së përgjithshme të nënprojektit përfituesit të nëngrantit brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshje dhe dorëzojnë konfirmimin në MAPL si dëshmi se pagesa është kryer.

6.2 Komuna do të pranojë vetëm pagesa të cilat janë në përputhje me shumën e dhënë të nëngrantit siç parashikohet në aplikacionin për nëngrant.

6.3 Komuna do ta sigurojë hapësirën dhe pajisjet e nevojshme për takime për ekipet e nënprojektit.

Neni 7 – Detyrimet e përfituesit të nëngrantit

7.1 Përfituesi i nëngrantit përdor fondet nga neni 3 i kësaj marrëveshje vetëm për zbatimin e nënprojektit dhe siç përcaktohet në buxhetin e nënprojektit.

7.2 Përfituesi i nëngrantit është i obliguar të siguroj çdo dokument ose informatë që kërkohet nga tërë aktorët e përfshirë në zbatimin e nënprojektit siç ceket në DOP dhe DNG.

7.2.1 Përfituesi i nëngrantit është i obliguar të mbaj shënime për transaksionet financiare të nënprojektit dhe aktivitetet e prokurimit të përcaktuara në DNG dhe ta dorëzoj raportin financiar në MAPL me dokumentacionin e të gjitha shpenzimeve dhe shtojcat.

7.2.2 Përfituesi i nëngrantit është i obliguar që të përpiloj planin e prokurimit për aktivitetet që duhet të procesohen përmes procedurave të prokurimit sipas doracakut të granteve. Përfituesi duhet të merr aprovim nga MAPL lidhur me planin e prokurimit, përpara se të filloj zhvillimin e ndonjë procedure për aktivitetet e prokurimit.

7.3 Përfituesi i nëngrantit është i obliguar të raportoj për progresin e nënprojektit dhe ta dorëzoj raportin përfundimtar narrativ në MAPL.

7.4 Përfituesi i nëngrantit duhet ta siguroj dukshmërinë e donatorëve gjatë zbatimit të përgjithshëm të nënprojektit.

7.5 Përfituesi i nëngrantit është i obliguar të raportoj në MAPL çdo ankesë të pranuar në lidhje me nënprojektin, përfshirë edhe ankesat nga komuniteti dhe përfituesit e të rinjve të nënprojektit.

Neni 8 - Forca madhore

Asnjë palë nuk mban përgjegjësi për mospërbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje në rast të forcës madhore.

Neni 9 – Ndërprerja dhe pezullimi

9.1 Nëse MAPL-ja përcakton se përfituesi i nëngrantit nuk po i përdor fondet e mbështetjes financiare siç duhet për ta zbatuar projektin sipas kushteve të kësaj kontrate dhe kushteve në DNG dhe DOP ose ka dështuar ta zbatojë projektin brenda periudhës së kontraktuar, nëse nuk i ka dorëzuar raportet e duhura me kohë ose nuk e ka lejuar MAPL-në ose palët tjera të interesuara të përfshira në zbatimin e projektit siç përcaktohet në Doracakun për Nëngrante dhe Doracakun e Operacionit të Projektit që ta mbikëqyrin shfrytëzimin e fondeve, do të pezullohen pagesat e mëtejshme dhe përfituesi është i detyruar t'i kthej mjetet të shpenzuara jo si duhet dhe ato të pashpenzuara brenda 30 ditësh nga marrja e njoftimit me shkrim për rimbursim nga MAPL-ja.

9.2 Nëse MAPL-ja përcakton se marrësi nuk i ka përbushur obligimet e veta kontraktuese, atij i mohohet e drejta për të marrë mbështetje financiare për dy vitet e ardhshme.

Neni 10 – Zgjidhja e konfliktit

Në rast të mosmarrëveshjeve gjatë zbatimit të kësaj kontrate ndërmjet palëve nënshkruese, të cilat nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim dhe diskutim të ndërsjellë, organi përgjegjës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë gjykata kompetente.

Neni 11 – Nënshkrimi i marrëveshjes

Kjo Marrëveshje do të ekzekutohet në gjuhën shqipe në tre (3) kopje origjinale. Secila palë do ta mbaj nga një (1) kopje origjinale, ku secila do të ketë fuqinë e njëjtë juridike.

Jeton QELA
Zavendësues i Sekretarit të
Pëgjithshëm - MAPL

Nënshkrimi

Data: 15.12.2023

Ramiz LLADROVCI
KOMUNA E GLOGOCIT

Nënshkrimi

Data: 11.12.2023

Vlera DIBRANI

Nënshkrimi

Data: 12.12.2023